

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM LICENSIMI DHE MIRËMBAJTE PËR FIREWALL FPR 1140”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 48000000-8
VLERA E FONDIT LIMIT: 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë, **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të sistemeve/ pajisjeve ngrohje/ftohje, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë” - ky standart është i nevojshëm pasi siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e sigurisë së informacionit. Zbatimi i këtij standardi mundëson menaxhimin e kontrolluar të rreziqeve që lidhen me mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të sigurisë dhe besueshmërinë në ekzekutimin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e licensave që janë objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40, pika 3 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar synon të sigurojë akses të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik në mbështetjen dhe garancinë teknike të prodhuesit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për këtë procedurë, për shkak të natyrës kritike të objektit të prokurimit dhe rëndësisë strategjike të sigurisë së informacionit për Policinë e Shtetit.

Pajisja e llojit firewall është një element kyç në infrastrukturën e sigurisë, pasi garanton integritetin e trafikut të brendshëm dhe komunikimet me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Funksionimi i qëndrueshëm dhe i pandërprerë i saj është jetik për strukturat e Policisë së Shtetit, ndaj kërkohet që ofertuesi të ketë mbështetjen dhe autorizimin e duhur për të ofruar produkte dhe shërbime të certifikuara nga prodhuesi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për realizimin e shërbimit, minimalisht si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalent).
- b) 1 (një) punonjës i certifikuar për operacionet e sigurisë në nivel profesional (CCNP Security ose ekuivalente).

Për punonjësit në pikën a) dhe b) duhet të paraqitet:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme; kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
- Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar), të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ a), b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili është thelbësor për realizimin e kontratës me sukses, duke pasur parasysh specifikat teknike dhe natyrën kritike të shërbimit.

Ky kriter është përcaktuar bazuar në analizën e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës të hartuar nga Autoriteti Kontraktor.

Punonjësi i certifikuar ITIL ose ekuivalent në menaxhimin e shërbimeve IT është i domosdoshëm për të siguruar administrimin korrekt të ciklit të jetës së shërbimit, raportimin e incidenteve dhe koordinimin e mirëmbajtjes në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ky rol garanton që proceset e suportit dhe ndërhyrjes teknike të jenë të dokumentuara, të gjurmueshme dhe në përputhje me politikat institucionale të sigurisë.

Kërkesa për staf të specializuar synon të sigurojë një nivel të lartë profesionalizmi dhe kompetence në ofrimin e shërbimit, për të mbrojtur infrastrukturën kritike të institucionit, si dhe për të garantuar funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të pajisjeve të sigurisë.

Punonjësi i certifikuar CCNP Security ose ekuivalent është thelbësor për operacionet teknike të projektit, duke përfshirë: inventarizimin e konfigurimeve ekzistuese të firewall-it ASA 5520, hartimin e planit të migrimit drejt FPR1140, integrimin e licencave, testimin dhe verifikimin e

funksionalitetit të rrjetit dhe sigurisë. Ky rol kërkon njohuri të avancuara në konfigurimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sigurisë Cisco.

Vendosja e këtij kriteri synon të garantojë një nivel të lartë profesionalizmi dhe sigurie teknike, të domosdoshëm për mbrojtjen e infrastrukturës kritike të Policisë së Shtetit dhe për të siguruar funksionimin e pandërprerë të sistemeve të sigurisë.

Dokumentacioni i kërkuar për secilin nga punonjësit shërben si provë për të provuar kapacitetet teknike të operatorit ekonomik lidhur me stafin e nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor “Departamenti për Teknologjinë dhe Informacionin”, bazuar në nevojat e të cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 *“Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”*, i ndryshuar.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

NJËSIA E PROKURIMIT